

70- vjetori i Brigadës së I-rë Sulmuese, "Heroinë e Popullit"

Rruga luftarake e Brigadës së I-rë Sulmuese, ashtu si e çdo reparti e njësie të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë është e mbushur me vepra heroizmi, vetmohimi dhe besnikërie të pakufishme ndaj popullit dhe Atdheut. Jeta dhe

veprimtaria e saj është aq e pasur me ngjarje dhe vepra revolucionare, politike e ushtarake të cilat kurrësi nuk mund të përshkruhen në një artikull, në një apo dy libra, por në shumë vëllime.

FAQE 2



Veterani

ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)
GAZETË DYJAVORE. NR. 63 (294) 15-31 GUSHT 2013. ÇMIMI: 20 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA

Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Tiranë.

Email: veterani.obvl@yahoo.com

Dritë e pashuar e kulturës shqiptare

Më 13 gusht, në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, salla "Tefta Tashko", në një ceremoni të veçantë u përkujtua 30-vjetori i ndarjes nga jeta të intelektualës së shquar Musine Kokalari. I pranishëm ishte dhe ministri i TKRS-se, Z. Visar Zhiti.

Musine Kokalari lindi më 10 shkurt të vitit 1917, në Adale të Turqisë. Në vitin 1921, familja e saj kthehet në Shqipëri dhe vendoset në Gjirokastrë, ku Musineja kreu shkollën fillore. Nëntë vjet më vonë, familja Kokalari vendoset në Tiranë. Në vitin 1937, Musineja mbaroi shkollën e mesme "Nëna Mbretëreshë" dhe më pas shkoi për studime në Universitetin e Romës, në Itali, të cilin e mbaroi shkëlqyeshëm në vitin 1941. Ajo botoi librin e saj të parë "Seç më thotë nëna plakë" në vitin 1939. Ishte viti 1943, kur Musine Kokalari së bashku dhe me disa shokë të tjerë formuan Partinë Socialdemokrate. Një vit më vonë, me përpjekjen e saj, doli numri i parë i gazetës "Zëri i Lirisë". Në vitin 1944, botoi librin e saj të dytë "Rreth vatrës", ndërsa më 12 nëntor të po këtij viti u pushkatuan vëllezërit e saj, Muntaz e Vesim Kokalari. Katër ditë më vonë e arrestuan dhe Musinenë, të cilën e mbajtën 17 ditë në burg. Në janar të vitit 1945, u botua libri i tretë i Musine Kokalari "Sa u tund jeta". Më 23 janar të vitit 1946, ajo u arrestua për së dyti nga forcat e Mbrojtjes së Popullit e gjyqi e dënoi me 20 vjet heqje lirie. Në vitin 1961, e nxjerrin nga burgu dhe e internuan në Rrëshen, ku dhe doli në pension me gjysmë page. Në vitin 1981, sëmuret nga sëmundja e kancerit, që dy vjet më pas do ta largonte përgjithmonë nga jeta. Dhjetë vjet më vonë, pra në vitin 1993, Presidenti i Republikës i dha pas vdekjes medaljen "Martir i Demokracisë".

FAQE 8

PAS LONDRËS, BUSTI I SKËNDERBEUT EDHE NË ZONËN ARBËRESHE, MOLISE REGIONE, ITALI



FAQE 3

Muhamer Spahiu ishte një burrë shteti, mbrojtës i flaktë i interesave kombëtare

Enver Hoxha, nuk i duronte njerëzit e ngritur e me autoritet, që kishin mendimet e tyre të drejta e i mbronin ato me burrëri, siç ishte Muhameri. Tek ata ai shikonte rrezikun më të madh të diktaturës dhe pushtetit të tij personal. Prandaj i goditi dhe i persekutoi. Kështu bëri edhe me Muhamerin për së dyti herë, duke e akuzuar se ai kishte pikëpamje revizioniste e po zbuste luftën e klasave në politikën me kuadrin, që sipas Enver Hoxhës ishte forca që çonte përpara shoqërinë.

FAQE 5

70 vjet nga krijimi i Batalionit Misto Mame

FAQE 4

Dedikim Post mortum, Kushtuar zonjës fisnike Shpresa Mazreku

FAQE 4

Dibra nderon dy ish pilotët Sefedin Tomçini dhe Sabri Toçi

FAQE 8

Njësia e parë e madhe dhe e organizuar e Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare shqiptare

70- vjetori i Brigadës së I-rë Sulmuese "Heroinë e Popullit"

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u hodhën themelet e Ushtrisë së rregullt popullore shqiptare. Brigada e I-rë ishte i pari formacion i madh i kësaj ushtrie të rregullt. Kjo brigadë nuk ishte një repart krahine ose qarku, siç ishin çetat, batalionet dhe grupet. Ajo ishte një njësi luftarake në dorë të Shtabit të Përgjithshëm, me partizanë nga të gjitha qarqet e vendit, që do të luftonte, lëvizte dhe manovronte në të gjitha krahinat e Shqipërisë, ku të paraqitej nevoja.

Rruga luftarake e Brigadës së I-rë Sulmuese, ashtu si e çdo reparti e njësie të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë është e mbushur me vepra heroizmi, vetmohimi dhe besnikërie të pakufishme ndaj popullit dhe Atdheut. Efektivit i Brigadës së I-rë pati vazhdimisht ndryshime. Më 8 tetor Brigadës iu shtuan edhe 150 partizanë italianë, të cilët formuan Batalionin "Antonio Gramshi" dhe në fund të marsit '44 u shtua edhe batalioni i 5-të. Brigada arriti kështu një efektiv prej 1237 luftëtarësh



Rruga luftarake e Brigadës së I-rë Sulmuese, ashtu si e çdo reparti e njësie të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë është e mbushur me vepra heroizmi, vetmohimi dhe besnikërie të pakufishme ndaj popullit dhe Atdheut. Jeta dhe veprimtaria e saj është aq e pasur me ngjarje dhe vepra revolucionare, politike e ushtarake të cilat kurrësesi nuk mund të përshkruhen në një artikull, në një apo dy libra, por në shumë vëllime.

Udhëzimet për krijimin e Brigadës së I-rë u lëshuan më 20 qershor 1943. Pikësynimi ishte që krijimin i këtij formacioni të parë të madh të shërbente për t'i dhënë vull krijimit të batalioneve e brigadave të tjera, të një ushtrie të rregullt partizane, të cilat do të ngjallnin një besim të madh për zhvillimin e luftës sonë, drejt Kryengritjes së Përgjithshme.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u hodhën themelet e Ushtrisë së rregullt popullore shqiptare. Brigada e I-rë ishte i pari formacion i madh i kësaj ushtrie të rregullt. Kjo brigadë nuk ishte një repart krahine ose qarku, siç ishin çetat, batalionet dhe grupet. Ajo ishte një njësi luftarake në dorë të Shtabit të Përgjithshëm, me partizanë nga të gjitha qarqet e vendit, që do të luftonte, lëvizte dhe manovronte në të gjitha krahinat e Shqipërisë, ku të paraqitej nevoja.

Brigadës së I-rë, si formacion i madh i ushtrisë së rregullt partizane ju ngarkua nga Shtabi i Përgjithshëm detyra që të shërbente si shembull për repartet partizane të të gjitha krahinave, për shndërrimin e tyre në formacione të rregullta. Pra, Shtabi i Përgjithshëm i kishte marrë të gjitha masat politike e organizative që Brigada e I-rë të bëhej me të vërtetë bërthama e shëndoshë për ushtrinë e rregullt.

Të gjitha qarqet e Shqipërisë kishin marrë udhëzime që kontingjentet e caktuara të ishin partizanë e kuadro me përvojë luftarake.

Qarqet e Korçës, Gjirokastrës, Elbasanit e Vlorës do të dërgonin grupet me numër më të madh partizanësh e kuadrosh. Shtabi i Përgjithshëm synonte që kjo njësi të organizohej, paisej dhe plotësohej me një efektiv të pathyeshëm dhe të drejtuar nga kuadro me përvojë ushtarake e revolucionare të lartë, për të përballuar goditje nga më të fuqishmet që do të organizonte armiku. Ky sulm i okupatorit ishte në planin e tij strategjik me qëllim që të pengonte me çdo kusht shkallëzimin e mëtejshëm organizativ e numerik të një ushtrie të rregullt Nacionalçlirimtare shqiptare. Këtë qëllim

armiku e tregoi dhe në ditët e inagurimit të Brigadës së I-rë duke angazhuar 10 000 trupa me paisjet luftarake më moderne të kohës, plus forcave të Ballit, milicisë, aviacionit etj, për ta asgjësuar atë që në krijimin e saj.

Organizimi i Njesisë

Shtabi i Përgjithshëm zgjodhi vendin më të përshtatshëm, rajonin e Vithkuqit për organizimin e Brigadës së I-rë. Katundi Vithkuq, 20 km në jugperëndim të Korçës, terren malor, ishte i përshtatshëm për të organizuar mbrojtjen. Popullsia e Vithkuqit dhe e fshatrave për rreth ishte 100 përqind në mbështetje të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Grumbullimi i grupeve partizane të ardhura nga drejtimet e caktuara filloj që në fundin e muajit korrik '43. Të parat erdhën forcat e Korçës (rreth 200 partizanë e kuadro) të cilat u vendosën në Manastirin e Shën Pjetrit. Më vonë mbërriti grupimi i Gjirokastrës që zuri vend në Pyllin e Shtyllës. Deri më 2 gusht mbërritën të organizuar edhe vullnetarët partizanë të qarqeve të Elbasanit, Beratit e Vlorës. Partizanë të veçantë pati dhe nga Tirana, Dibra, Durrësi, Kukësi e Shkodra. Në efektivin e Brigadës I-rë erdhën dhe dhjetë vajza partizane. Në fillim Brigada pati një efektiv prej 556 partizanë. Midis tyre 70 kishin qenë kuadro drejtuese si komandantë e komisarë batalionesh e çetash, komandantë njësitesh guerrile, me përvojë të pasur luftarake e të kalitur në vështirësi.

Në datën 10 gusht përfundoi organizimi i Brigadës me katër batalione dhe tre kompani: një kompani mortajash, një kompani pushk kundërtank dhe një bateri artilerie. Një vëmendje e posaçme iu kushtua shërbimit të intendencës. Shtabi i Përgjithshëm për këtë shërbim kishte parasysh se Njësia do të lëvizte nga një krahinë në tjetrën, herëherë me shpejtësi të madhe. Kuptohet që Brigada duhet të kishte një furnizim dinamik, sidomos me municione. Prandaj ndërtime i këtij shërbimi u organizua në përshtatje me kërkesat e detyrat e Njesisë. Një përforsim i veçantë ju bë intendencave të batalioneve.

15 gusht 1943 - dita e inagurimit

Po afrohej 15 gushti, dita e inagurimit. Ceremonia do të zhvillohej në fushën e vogël të Makërzës, që shtrihet në luginën midis kodrave e pyjeve.

Në Vithkuq prej dy javësh qëndronte Shtabi i Përgjithshëm dhe udhëheqës të tjerë

të Luftës. Qarkori i Korçës kishte marrë të gjitha masat përgaditore për festën dhe mbrojtjen e nevojshme me forcat e vendit. Në sheshin e Makërzës ishin vendosur banderola, flamuj e parulla të ndryshme dhe në qendër tribuna me gjethe e mjete rrethore. Që në orët e para po vinin aktivistë të fshatrave e qyteteve si nga Korça, Pogradeci, Erseka, Devolli etj. Në orën 9.00 u rreshtuan para tribunës katër batalionet dhe repartet e armëve të rënda me të gjitha pajimet dhe armatimet e tyre. Në mëndjet dhe zemrat e gjithë efektivit të Brigadës ndjehej një gëzim dhe gjallërim i pakufijshëm. Ishte nder i madh të bëje pjesë në këtë brigadë, që ishte njësia e parë e madhe dhe e organizuar e Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare shqiptare. Në sytë e sejcilit lexohej gëzimin, krenarinë dhe vendosmërinë për t'i kryer detyrat luftarake deri në vetëflijim.

Të gjithë prisnin me padurim fillimin e ceremonisë. Në orën 10 mbërritën udhëheqësit e PK me E.Hoxhën në krye dhe të Shtabit të Përgjithshëm, të cilët zunë vend në tribunë.

Ceremonia u hap me hymnin e flamurit, kënduar nga kori. Pastaj e mori fjalën Spiro Moisiu, Komandant i Shtabit të Përgjithshëm i cili përshëndeti në emër të Shtabit të Përgjithshëm, duke dorëzuar flamurin në formë trekëndëshi me shkabën dykrenare dhe me yllin e artë, me mbishkrimin: "Brigada e I-rë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare". Ai u shpreh: "Ju dorëzoi këtë flamur në emër të

Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe kam porosi prej tij t'ju them që të mos e lini kurrë të bjerë në duart e armikut, por ta ngrini gjithmonë lart e ta çoni nga fitorja në fitore".

Komandanti i Brigadës, shoku Mehmet Shehu e mori flamurin dhe në emër të luftëtarëve bëri betimin përpara Shtabit të Përgjithshëm me fjalët: "Betohej se këtë flamur që na dorëzoi Shtabi i Përgjithshëm do ta mbajmë kurdoherë lart. Do të jemi besnikë ndaj popullit dhe do të zhvillojmë luftë të paepur kundër fashizmit okupator dhe armiqve të popullit, për krijimin e një Shqipërie të lirë dhe demokratike popullore". Këtyre fjalëve ju bënë jehonë zërat e njëkohshëm dhe të zjarrtë të partizanëve: "Betohej". Gjithë sheshi gjëmoi nga duartrokitjet dhe thirrjet e të pranishmëve "Rroftë Brigada e I-rë Sulmuese" etj. Në këtë ceremoni folën oratorë të ndryshëm.

Ceremonia u mbyll me parakalimin e Brigadës. Në fushë nuk ndjehej asgjë përveç hapit luftarak të partizanëve. Oshëtima e hapit përçillej larg nëpër pyje e male. Pas ceremonisë, deri vonë në mbrëmje buçitën këngët dhe vallet partizane...

Efektivit i Brigadës së I-rë pati vazhdimisht ndryshime. Më 8 tetor Brigadës iu shtuan edhe 150 partizanë italianë, të cilët formuan Batalionin "Antonio Gramshi" dhe në fund të marsit '44 u shtua edhe batalioni i 5-të. Brigada arriti kështu një efektiv prej 1237 luftëtarësh.

Drejtuesit e Brigadës së Parë Sulmuese

- | | | |
|------------------------|------------------------|---|
| 1. Mehmet Shehu | 19. Myslim Shyri | 37. Xhelo Faslliu |
| 2. Tuk Jakova | 20. Ndreko Rino | 38. Fejzi Micolli |
| 3. Arif Hasko | 21. Rraqi Themeli | 39. Gazali Sejko |
| 4. Muhamet Prodan | 22. Xheladin Beqiri | 40. Teme Sejko |
| 5. Sadik Bocaj | 23. Ziqiri Mero | 41. Axhem Abazi |
| 6. Fiqeret Sanxhaktari | 24. Ndreçi Plasari | 42. Raqi Babaliu |
| 7. Mihal Prifti | 25. Mexhit Çela | 43. Andrea Konomi |
| 8. Aleks Verli | 26. Xhelal Staravecka | 44. Gaqo Taçi |
| 9. Dhori Panariti | 27. Vehbi Hoxha | 45. Ilo Trako |
| 10. Feti Smokthina | 28. Selman Brahimi | 46. Delo Sedie |
| 11. Ferit Radovicka | 29. Panajot Plaku | 47. Gaqo Shoshi |
| 12. Gjeli Argjiri | 30. Irakli Terova | 48. Nuçi Tira |
| 13. Gjok Doçi | 31. Beqir Baho | 49. Pertef Pumo |
| 14. Idris Seiti | 32. Tercilio Kardinali | <i>Hymni i brigdes se pare sulmuese u shkrua nga Tuk Jakova muziaka u be nga Dhora Leka, kompozitorja e talentuar e dhjetera kengeve partizane.</i> |
| 15. Jovan Naska | 33. Xhuzepe Monti | |
| 16. Kostaq Gushe | 34. Alfredo Dandili | |
| 17. Xhelal Mato | 35. Domeniko Bogatoj | |
| 18. Petro Lalaj | 36. Todri Naço | |

PAS LONDRËS, BUSTI I SKËNDERBEUT EDHE NË ZONËN ARBËRESHE, MOLISE REGIONE, ITALI

Më 4 gusht 2013, në fshatin arbëresh Munxhufuni, u vendos busti i Skënderbeut. Ishte një ditë e jashtëzakonshme për bashkësinë e atyshme, por edhe për ne që morëm pjesë. Bashkë me Ambasadorin e Shqipërisë në Itali, Z. Neritan Ceka përjetuam momente shumë të forta emocionale, tek shihnim gëzimin e atyre njerëzve që ende e ruajnë të fortë ndjenjën e dashurisë dhe krenarisë për origjinin e tyre

nga Mal Berisha

Me datën 28 nëntor 2012, në ditën e 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar, bashkë me bashkëatdhetarët tanë në Britaninë e Madhe, vendosëm bustin e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, në një vend shumë të bukur në Beysëater, Londër. Ky bust është e vetmja shenjë vizuale publike e pranisë së shqiptarëve në Mbretërinë e Bashkuar e shfaqur në ndonjë formë qoftë artistike, apo e ndonjë forme tjetër, gjatë historisë. Gjërat në këtë botë janë kaq të lidhura sa shpesh një vepër e mirë i hap rrugën një vepre tjetër. Kështu ndodhi edhe me këtë bust të Skënderbeut.

Një ditë, këtu në Londër, stacioni i mirënjohur BBC organizoi një debat televiziv për krizën financiare në Europë. Isha i ftuar edhe une. Arrita në kohën e duhur. U prezantova, gjeta emrin në listë dhe dorëzova kartën e identitetit të punës. Një prej vajzave që i priste të ftuarit e mori atë, e lexoi, dhe më tha në gjuhën shqipe:

“Unë jam Mavi, Mavi Victoria. Unë flasi arbërisht. Unë jam italiane. Si je mirë? Unë jam mirë. Une flasi arbërisht në shtëpi me baba dhe mama ime”.

U habita dhe këmbëngula të mësoja nëse ishte arbëreshe derisa fliste shqip. Por jo. Mavi megjithë dëshirën time që të ishte arbëreshe, nuk ishte e tillë. Ajo ishte mbesë e dy mësuesve të vjetër italianë, të cilët qeveria italiane i kishte caktuar në fshatin Munxhufuni – Montecilfone në rajonin Molise të Italisë. Mbarova bisedën me te dhe u ndame me shijen që të lë përherë kënaqësia kur dëgjon një të huaj që flet gjuhën e nënës tënde.

Disa javë më vonë mora një e-mail prej Mavit dhe u takuam në zyrën time në Ambasadë. U habita fare kur pashë që ajo më kishte sjellë një revistë të botuar nga Bashkia e Molises ku gjëndej edhe një foto e imja të cilën ajo e kishte gjetur në fshatin e saj arbëresh. Ishte një foto e bërë bashkë me Ambasadorin tonë të athershëm në Romë, z. Llesh Kola kur inaguruam Konsullin e Nderit



të Shqipërisë, Dr. Savine Cannone, por që për hir të vërtetës nuk e kisha parë atë foto ndonjëherë. Në tërë atë fshat, vetëm familja e saj ishin italianë. Ajo më solli edhe disa DVD, broshura dhe fjalorë më fjalë të gjuhës shqipe në variantin e saj arbëresh.

Unë e kisha vizituar Campobasson, madje ai është vend i parë që kam vizituar në Itali me detyrë zyrtare, kur inaguruam Konsullin e Nderit. Ai është Drejtor i Spitalit Gemeli në Campobasso, dhuratë për atë zonë e Papa Gjon Pavlit të II - të. Papa ua dhuroi atyre banorëve atë spital pasi doktori që e shëroi atë pas atentatit të kryer nga Mehmet Ali Ağca ishte nga ajo zonë. Por asnjëherë nuk më kishte shkuar mendja se një ditë do të shkoja me një mision tjetër dhe pikërisht:

Mavi Viktoria, vizitoi bustin e Skënderbeut në Londër dhe pasi mori ca fotografi të tij vajti në Molise. Atje ajo e bisedoi mundësinë e vendosjes së një busti në qendër të fshatit në Sheshin Skënderbeg me kryetarin arbëresh të Bashkisë z. Franko Pallota. Pastaj u kthye në Ambasadë në Londër dhe kërkoi ndihmë. Ndihmë për të gjetur një bust si ai i Londrës, ndihmë për ta shkruar atë në bronx, ndihmë për ta sponsorizuar atë. Kur ekziston vullneti i mirë tërë gjërat zgjidhen. Kështu, bustin e ribëri, e dërgoi në fonderi dhe e postoi për në Manxhufuni, skulptori i talentuar Kreshnik Xhiku; sponsorizimin e siguruam me biznesmenin e njohur dhe



patriot z. Shefqet Kastrati dhe të birin Leonardin; me organizimin merret Mavi Victoria dhe kryetari i Bashkisë z. Franko Pallota bashkë me Ambasadën shqiptare në Londër dhe atë në Romë.

Më 4 gusht 2013, në fshatin arbëresh Munxhufuni, u vendos busti i Skënderbeut. Ishte një ditë e jashtëzakonshme për bashkësinë e atyshme, por edhe për ne që morëm pjesë. Bashkë me Ambasadorin e Shqipërisë në Itali, Z. Neritan Ceka përjetuam momente shumë të forta emocionale, tek shihnim gëzimin e atyre njerëzve që ende e ruajnë të fortë ndjenjën e dashurisë dhe krenarisë për origjinin e tyre. Dhe jo vetëm kaq, por kur i degjonim të na flisnin në gjuhën tonë të vjeter shqipe.

Në Molise Regione përuaruam kështu atë bust të Skënderbeut bashkë me vëllëzërit tanë arbëresh, autoritete lokale italiane, Kryetarin e Bashkisë së Molises, Ambasadën tone në Itali, diplomatë të ambasadës tonë në Londër, Konsullin tonë të Nderit në Campobasso dhe natyrisht Mavi Viktorian dhe familjen e saj përfshirë gjithë e saj 90 vjecare. Aty takohemi me njerëzit e gjakut tonë Profesor Francesko Altinari, Mikelanxhelo La Luna, e sa e sa arbëreshë të tjerë.

Dua të falenderoj me këtë rast italianen Mavi Victoria për iniciativën e marrë, skulptorin Kreshnik Xhiku për punën e shkëlqyer që ka bërë për krijimin dhe derdhjen në bronx të veprës dhe padyshim sponsorin kryesor të saj, zotin Shefqet Kastrati dhe të birin zotin Leonard Kastrati si dhe Bashkinë e Molises.

Unë besoj se kjo do të frymëzojë edhe bashkatdhetarët tanë kudo që janë jashtë atdheut që të mendojnë për një çast se

sa e rëndësishme është kjo. Arbëreshët i kanë dhënë kulturës shqiptare por edhe asaj botërore figura si Francesco Crispi, 2 herë Kryeministër i Italisë, Papa Klementin e XI – Alban, Nikolla Barbaton, Zef Seremben, Jeronim De Radën, Jul Varibobën, Terenc Tocin, Antonio Gramshin, Ernesto Sabaton, Xhozef DioGuardin dhe të bijën Kara Dioguardi, Regis Filbinin, Roberto De Niron e sa të tjerë. Ne jemi krenar për ta. Por edhe duhet të ndjehemi keq përpara tyre kur fëmijët tanë të brezit të parë po e humbasin gjuhën tonë të ëmbël shqipe ndërsa ata e ruajnë edhe sot, në dhe të huaj më dashuri dhe madje fanatizëm.

Më 3 gusht, një ditë para inagurimit të bustit të Skënderbeut në Manxhufuni, patëm rastin e fortlumtur të marrim pjesë në hapjen e ekspozitës së piktores arbëreshe, Liliana Corfiati, me vepra të saj si dhe me njëzet punë origjinale të piktorit tonë të madh, Ibrahim Kodra. Këto punë janë pjesë e koleksionit privat të piktores Corfiati, të gjitha të dhuruara nga vetë piktori Kodra. Secila prej tyre kishte një histori më vete. Të gjitha Kodra i kishte pikturuar ndërsa darkonin, flisnin për Shqipërinë dhe ia dhuronte me dedikim. Madje njëra prej tyre mban vetë emrin e Lilianës. Ekspozita u hap në një mjedis të mbyllur, shumë antik. Por veprat e Lilianës shtriheshin në tërë qendrën e Campomarinës, në çdo rrugë dhe dalloheshin për motivet që në shumë raste rikujtonin eksodin e arbëreshëve drejt Italisë. Si rezultat i dekorimit artistik nga ana e kësaj piktorje ishte shtuar në mënyrë të ndjeshme numri i turistëve. Fotografitë e marra në Campomarinë flasin vetë.

Historia e batalionit që u krijua në kulmin e luftës kundër pushtuesve nazi-fashistë

70 vjet nga krijimi i Batalionit Misto Mame



Dedikim Post mortum, Kushtuar zonjës fisnike Shpresa Mazreku

nga Dukagjin HATA

Para disa ditësh ndërroi jetë Shpresa Mazreku, bijë e familjes historike të Biçakçinjve të Elbabasnait, bashkëshortja e të ndjerit Vili Mazreku, mjek dhe intelektual i njohur nga dera e Mazrekëve të Shkodrës, nëna e avokatit dhe publicistit të mirënjohur, Serxhio Mazreku. Ajo ishte një grua e rrallë, një nënë e mrekullueshme, një femër dinjitoze, që e përballoi jetën me përkushtim ndaj familjes e farefisit, me krenari, si trashëgimtare e vlerave më të mira të derës fisnike nga erdhi nuse dhe të derës po aq fisnike ku nisi jetën e saj të re, në krah të mjekut të njohur Vili Mazreku. Në dedikim të kësaj gruaje të rrallë dhe të mikut tim Serxhio Mazreku, i cili e pati atë nënë dhe e deshi me një dashuri të pakufishme, unë shkrova këtë poezi.



Ti ike, ike, o nënë fisnike,
Ike ti në rrugën e pa kthim
Pas le kujtimin tënd si një relike
Kujtimi yt do rrojë gjer në amëshim.

Ç'të mbeti peng në çastet e fundit?
Tani është vonë dhe drita u shua.
Mungesa jote end pëlhurën e dhimbjes
Dhe loti i pastër në faqe rrodhi krua.

O bijë e derës së madhe t'Biçakçinjve
O mbesë e Aqif Pashës, e të madhit burrë,
Ti pive ujë, o nënë, n'Eden të bukuive
Dhe geni yt fisnik nuk do shuhet kurrë.

Mos u ligështo, Serxho, miku im,
Çdo burrë apo grua e ka një nënë
Dhe nëna tek biri rron në pambarim
Sa të ketë mbi tokë diell edhe hënë.

Batalioni "M.Mame" u krijua mbi bazën e katër çetave partizane, si ajo e "Prokop Meksit", "Mihal Durit", "Lato Brahos" e "Sabaudin Gabranit, të dala nga gjiri i krahinave të Rrëzës, Lunxhërisë, Libohovës e më gjerë, krahina këto baza të rëndësishme të LANÇ, me 384 djem e vajza trima të këtyre krahinave e nga qyteti i Gjirokastrës

Shtatëdhjet vjet më parë, më 16 gusht 1943 në fshatin Stegopol, u krijua Batalioni Partizan "Misto Mame" në kujtim të të cilit është ngritur një lapidar madhështor, batalion i cili u krijua në kulmin e luftës kundër pushtuesve nazi-fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, si një formacion luftarak që mori përsipër një mision të lartë atdhetar.

Batalioni "M.Mame" u krijua mbi bazën e katër çetave partizane, si ajo e "Prokop Meksit", "Mihal Durit", "Lato Brahos" e "Sabaudin Gabranit, të dala nga gjiri i krahinave të Rrëzës, Lunxhërisë, Libohovës e më gjerë, krahina këto baza të rëndësishme të LANÇ, me 384 djem e vajza trima të këtyre krahinave e nga qyteti i Gjirokastrës, të cilët, të frymëzuar nga heroizmi i djemve lunxhotë Misto Mame e Mihal Duri, rrokën armët dhe i dolën zot vatanit. Komandant i këtij batalioni u caktua patrioti trim Lipe Boga, komisar intelektual i mirënjohur gjirokastrit Zini Sako, zv.komisar Vasil Kati dhe zv.komandant Misto Çipi.

Por, Batalioni "Misto Mame", pati dhe mjaft kuadro që komandonin kompanitë përbërëse të këtij batalioni, si Thimjo Muçi, Sotir Mero, Miço Boga, Pano Xhixho, Polo Bezhani, Isuf Çobani, Vasil Miçi, Skënder Kumbaro, Piro Koçi, Gjolek Kokona, Nane Kutra, Luto Haxhi, Maze Ruçi, Koço Koçi, Agron Çomo etj., aftësitë drejtuese dhe trimëria e të cilëve ishin provuar si komandantë e komisarë çetash, apo në beteja të zhvilluara më parë.

Kuadrot komanduese të Batalionit "M.Mame", duke bashkëpunuar ngushtë me njësitet guerile të fshatrave dhe me mbështetjen e plotë të popullit të këtyre krahinave, e udhëhoqën këtë njësi në një varg betejash luftarake kundër forcave pushtuese dhe bashkëpunëtorëve të tyre, sikurse kanë qenë: ajo kundër garnizoneve italiane në Libohovë, kundër forcave gjermane në Qafën e Muzinës, në luftën e Borshit, të Sarandës, Spilesë, Himarës, Kurveleshit, në krahinën e Theollogos, në Tendën e Qypit, në rrethinat e Peqinit, etj., në të cilat u shpalos me tërë madhësinë e vet shpirti i sakrificës dhe i vetmohimit, i guximit dhe patriotizmit të partizanëve dhe kuadrove, duke hapur një faqe të ndritur në historinë e Shqipërisë, atë të çlirimit të Shqipërisë.

Në themel të kësaj fitoreje të madhe të ushtrisë së ANÇ, ku përfshihej edhe Batalioni "M.Mame", është gjaku i 28 mijë dëshmorëve, midis të cilëve edhe i 61 bijve e bijave të pavdekshëm të këtij batalioni, ndaj të cilëve populli shqiptar përulet me respekt të thellë për aktin sublim të tyre.

Prandaj, të mbrosh sot gjakun e të rënëve dhe idealet dhe vlerat e LANÇ, është detyrë jo vetëm e shenjtë, por dhe patriotike, kundër atyre përpjekjeve të dëshpëruara që bëhen për denigrimin e tyre.

Homazh për një pasardhës veterani

nga Osman XHINDOLI



Më 26 Korrik 2013 u nda nga jeta Novruz Mane Karehmani. Ai kishte lindur në Sukë të Roskovecit në vitin 1935. Prej 15 vitesh ishte pasardhës veterani. Familja e tij është ndër më të nderuarat e Shijakut e të gjithë zonës.

Shtëpia e Novruz Karehmanit në Sukë ka qenë bazë kryesore e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Babai i tij, Maneja ishte kryetar i Këshillit krahinor për gjithë zonën e Roskovecit. Dy djemtë e tij, Enveri dhe Saliu kanë qenë partizanë në Grupin e Myzeqesë dhe më vonë në Brigadat e 7-të dhe të 16-të Sulmuese.

Në këtë shtëpi kanë qëndruar më ditë dhe javë të tëra udhëheqësit e LANÇI, Spiro Moisiu, Zylyftar Veleshnja, Spiro Bakalli, Ajet Xhindoli, Myftar Xhindoli, Myqerem Fuga, Mane Nishova, Novruz Gjergjova, e sa

e sa të tjerë.

Mbas çlirimit Mane Karehmani, për vite me radhë punoi si komandant i Komandës së Vendit në Roskovec, ndërsa dy djemtë: i madhi oficer në ushtri dhe tjetri në organet e policisë.

Novruzi, shkollën fillore dhe 7-vjeçare i kreu në Roskovec. Nuk vazhdoi më tej për arsye familjare.

Në vitin 1956 fillon punë në Ndërmarrjen e Bonifikimit si traktorist, sepse gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak kishte kryer kurs 6-mujor për këtë profesion.

Për 30 vjet të tjera ai ka punuar pa u lodhur me stalinieze e buldozer në të gjitha veprat e mëdha, nga Konispoli në Kukës, Peshkopi e Tropojë. Pikërisht për meritat në punë ai ishte dekoruar me "Urdhërin e Punës të Klasit I-rë", dhe me dekorata të tjera, fletë nderi e fletë lavdërimi. Ai ishte i talentuar, mekanik shumë i zoti, elektrikist, hidraulik. Si i thonë, ç'ia shihte syri ia bënte dora. Ishte duarartë.

Për katër dekada që familjarisht ka banuar në Shijak, ka qenë dhe mbetet familje e nderuar e këtij qyteti. Është e tillë sepse i tillë ka qenë dhe mbetet Novruzi, e tillë është bashkëshortja e tij fisnike, Znj.Rabushe...; të tillë janë famijët, nipërit dhe mbesat e tij.

Qytetarët e Shijakut u hidhëruan për vdekjen e tij dhe e përcollën atë për në banesën e fundit me lotë në sy dhe me buqeta me lule.

Ai ka lënë pas një familje solide që gëzon respekt dhe dashuri nga gjithë qyteti i Shijakut.

Në kujtim të një prej iniciatorëve të parë, organizator i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

Muhamer Spahiu ishte një burrë shteti, mbrojtës i flaktë i interesave kombëtare

Nga Rrahman PARLLAKU*

Enver Hoxha, nuk i duronte njerëzit e ngritur e me autoritet, që kishin mendimet e tyre të drejta e i mbronin ato me burrëri, siç ishte Muhameri. Tek ata ai shikonte rrezikun më të madh të

diktaturës dhe pushtetit të tij personal. Prandaj i goditi dhe i persekutoi. Kështu bëri edhe me Muhamerin për së dyti herë, duke e akuzuar se ai kishte pikëpamje revizioniste e po zbuste luftën

e klasave në politikën me kuadrin, që sipas Enver Hoxhës ishte forca që çonte përpara shoqërinë. Kështu që nga viti 1960 për Muhamerin e familjen e e tij filluan sërish ndjekjet e persekutimet e

tmerrshme: dëbim, internim, burgim e prapë internim për 30 vjet me radhë. Muhamerin e familjen e tij i ndoqi i njejt fat që ka ndjekur me mijëra familje shqiptare, shokë e bashkëluftëtarë të tij

Më 11 gusht u mbushën tetë vjet që kur u nda nga fëmijët, të afërmit, ne shokët e bashkëluftëtarët e tij, Muhamer Spahiu.

I lindur në një familje të nderuar qytetare, Muhameri mori një edukatë të shëndoshë. Ai që në rininë e herëshme u dallua për sjellje shembullore, ndërshtëri e përkushtim në mësim.

Edukimin me ndjenja atdhetare, Muhameri e tregoi që në moshën 15 vjeçare. Kur ishte në bangat e shkollës ai u përfshi në Lëvizjen Antifashiste dhe u dallua në mes të të rinjve për vendosmëri e guxim në luftë, duke u bërë një nga udhëheqësit në

organizatat e rinisë antifashiste të Tiranës. Për aktivitetin e tij në Luftën Antifashiste, Muhameri u përndoq e u burgos nga fashistët dhe pas daljes nga burgu u bë një nga udhëheqësit kryesorë të rinisë së kryeqytetit. Ai u tregua i vendosur e trim edhe në luftimet me armiqtë, kur ndodhej me shërbim në repartet partizane, kur në përlëshjen me nazistët gjermane mori plagë në trup gjatë Operacionit Armik të Dimrit 1944.

Muhameri, një kontribut të veçantë ka dhënë në mobilizimin e rinisë së kryeqytetit për të mbushur radhët e ushtrisë partizane me të



rinj të vendosur që treguan guxim e trimëri në luftë.

Për aktivitetin e tij si drejtues i Rinisë Antifashiste të kryeqytetit, Kongresi i Parë i Rinisë i mbajtur në Gusht 1944 në Helmës të Skraparit e zgjodhi Muhamerin në Sekretariatit e Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare. Pas çlirimit të Atdheut, Muhamerit iu ngarkuan detyra të larta shtetërore: më 1947 zv/kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit, më pas Zëvendës i parë i Ministrisë të Industrisë; Sekretar i Përgjithshëm i Kryeministrisë dhe përfaqësues i Shqipërisë në Këshillin Ekonomik të ish vendeve socialiste (KNER). Në të gjitha detyrat e ngarkuara ai punoi me përkushtim, profesionalizëm e kooperencë.

Muhameri kishte kulturë të gjerë, sidomos si ekonomist. Ishte diplomuar me rezultate të larta në këtë degë.

Muhameri qe burrë shteti dhe personalitet; parimor, i palëkundur në parimet e tij – mbrojtës i flaktë i interesave kombëtare. Ai pati burrërinë t'i thotë hapur e t'i mbrojë mendimet e tija. Për këtë qëndrim parimor u persekutua e u dënua nga diktatura e egër e Enver Hoxhës. Më 1948 Muhameri u dënua si bashkëpunëtor i Nako Spirut, pasi bashkë me të kishin mbrojtur me vendosmëri interesat kombëtare kundër ndërhyrjes së jugosllavëve në punët e brendshme të Shqipërisë që donin ta kthenin vendin tonë në koloni të tyre. Pas Kongresit të Parë të Partisë Komuniste Shqiptare, Muhameri u rehabilitua dhe mori përsëri funksione të larta shtetërore, por siç dihet diktatori Enver Hoxha, nuk i duronte njerëzit e ngritur e me autoritet, që kishin mendimet e tyre të drejta e i mbronin ato me burrëri, siç ishte Muhameri. Tek ata ai shikonte rrezikun më të madh të diktaturës dhe pushtetit të tij personal. Prandaj i goditi dhe i persekutoi. Kështu bëri edhe me Muhamerin për së dyti herë, duke e akuzuar se ai kishte pikëpamje revizioniste e po zbuste luftën e klasave në politikën me kuadrin, që sipas Enver Hoxhës ishte forca që çonte përpara shoqërinë. Kështu që nga viti 1960 për Muhamerin e familjen e e tij filluan sërish ndjekjet e persekutimet e tmerrshme: dëbim, internim, burgim e prapë internim për 30 vjet me radhë. Muhamerin e familjen e tij i ndoqi i njejt fat që ka ndjekur me mijëra familje shqiptare, shokë e bashkëluftëtarë të tij.

Me fitoren e lëvizjes demokratike, Muhameri u përfshi në shumë veprimtari shoqërore në mbështetje të zhvillimeve demokratike në vend. Ai qe një nga iniciatorët e parë dhe organizatorët e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Si nënkryetar i kësaj organizate e kryetar i OBVL për Tiranën ai dha një kontribut të veçantë në të gjitha aktivitetet që kreu OBVL në përkujtimin e ngjarjeve historike kombëtare e veçanërisht të LANÇ e figurave drejtuese të saj. Muhameri bëri një punë të madhe e me përkushtim të veçantë për të mobilizuar të gjithë veteranët e organizatës tonë, familjarët e të afërmit e tyre në ndihmë të vëllezërve tanë kosovarë, të dëbuar prej trojeve të tyre etnike nga kasapi i Ballkanit, Millosheviç. Ai e përjetoi me gëzim të madh fitoren e popullit të Kosovës ndaj pushtuesve serbë. Veçanërisht kur shkeli mbi tokën e lirë të Kosovës gjatë vizitës që bëri delegacioni i OBVL në shtator 1999 me ftesë të veteranëve të Luftës Antifashiste të Kosovës, duke u shprehur se “tani m’u plotësua një nga dëshirat e mia të jetës”.

Muhameri qe bashkëshort e prind i shkëlqyer. Ai pati një përkujdesje të veçantë për bashkëshorten e bashkëluftëtarin e tij, Fatbardhën, për rritjen e edukimin e dy vajzave të tij të dashura. Edhe në moshë të thyer qe shumë i përkujdesur për nipërit e tij. Në bashkëluftëtarët e bashkëpunëtorët, por edhe gjithë shokët e miqtë e tij do ta kujtojmë Muhamerin me dashuri e respekt. Dhe jo vetëm ne por i gjithë rrethi shoqëror që e ka njohur. Kujtimi i tij do të mbetet i paharruar.

*Hero i Popullit, gjeneral-lejtnant

Thaçi: Zbatimi i marrëveshjes Kosovë-Serbi, sfida kryesore



PRISHTINË- Zbatimi i marrëveshjes Kosovë-Serbi është sfida jonë kryesore dhe duhet të angazhohemi të gjithë për këtë proces, deklaroi kryeministri kosovar, Hashim Thaçi.

Gjatë vizitës në komunën e Ferizajt, Thaçi tha se “besoj se Beogradi ka ende dilema për të pranuar marrëveshjen sa i përket telekomunikacionit dhe energjisë, ndërsa sa i përket Prishtinës dhe Bashkimit Evropian, kjo çështje është e mbyllur”.

Në interes të medias, kryeministri Thaçi shtoi se, “marrëveshjet janë në përputhshmëri të plotë me kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe gjithçka që është e lejueshme me Kushtetutë është edhe e pranueshme”. Kreu i Qeverisë së Kosovës përsëriti mesazhin drejtuar serbëve në veri për përgatitjet e tyre për zgjedhje, regjistrim të partive politike, iniciativave qytetare dhe pjesëmarrjen në zgjedhje.

Beogradi ka ende dilema për të pranuar marrëveshjet me Prishtinën

“Gjithçka është e qartësuar në marrëveshjet edhe për IBM-in, gjithashtu edhe në marrëveshjen e 19 prillit, për të gjitha aspektet edhe teknike edhe profesionale. Marrëveshjet janë në përputhshmëri të plotë me kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe gjithçka që është e lejueshme me kushtetutë është edhe e pranueshme. Por ajo që është shumë me rëndësi, është që të punohet edhe më tepër në implementim. Është duke vazhduar implementimi në segmente të ndryshme dhe shpresoj se po krijohet gradualisht një ambient i pranueshëm për të punuar bashkërisht të gjithë qytetarët edhe në veri, në mënyrë që të organizojmë zgjedhje të lira me 3 nëntor, në gjithë territorin, duke marrë pjesë të gjithë qytetarët e vendit pa dallim etnik dhe në kuadër të kësaj edhe serbët në veri. Dhe më lejoni që përmes jush përsëri t’ju dërgoj mesazhin e përgatitjes së tyre për zgjedhje, regjistrimit të partive politike, iniciativave qytetare dhe pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje.

Pjesëmarrja e tyre në zgjedhje hap një kapitull të ri, atë të fillimit të ndërtimit të demokracisë edhe në atë pjesë të Kosovës, dhe pastaj edhe fillimin e investimeve

ekonomike për të ndërtuar një jetë të përbashkët. Pjesëmarrje në zgjedhje është jetike për të ardhmen e sigurt zhvillimore dhe demokratike edhe në veri dhe jam optimist se kjo do të ndodhë”, tha kryeministri.

Ai e ka pranuar se ka ngecje edhe sa i përket telekomunikacionit dhe energjisë duke thënë se Beogradi ka ende dilema për ta pranuar marrëveshjen dhe se sipas tij nuk është hera e parë që Beogradi pretendon të zvarrit procesin për zbatim. “Besoj se Beogradi ka ende dilema për të pranuar marrëveshjen sa i përket telekomunikacionit dhe energjisë, ndërsa sa i përket Prishtinës dhe Bashkimit Evropian kjo çështje është e mbyllur. Kështu që unë shpresoj që në ditët e ardhshme edhe Beogradi do të bindet për të pranuar marrëveshjen që është e standardit evropian e nevojshme dhe e domosdoshme për të lëvizur proceset përpara. Por, nuk është hera e parë që Beogradi tenton të zvarrisë procesin veçanërisht procesin e implementimit. Implementimi mbetet sfida jonë kryesore. Ne duhet të angazhohemi të gjithë, por jam informuar se Bashkimi Evropian është në kontakt të rregullt me autoritetet në Beograd, në mënyrë që të arrihet marrëveshja sa më shpejt, kështu që shpresoj që të arrihet në të ardhmen e afërt”, theksoi ai.

PHILIP REEKER PERSHENDET AUTORITETET E PRISHTINES E BEOGRADIT PER MARREVESHJET E ARRITURA NE BRUKSEL

Zëvendës Ndihmësi i Sekretarit amerikan të Shtetit, Philip Reeker, ka pershendetur autoritetet në Prishtinë dhe Beograd për marrëveshjet e arritura në Bruksel dhe ka thënë se Shtetet e Bashkuara mbesin të përkushtuara për të mbështetur integrimin evropian të të gjitha vendeve të rajonit.

Ai ka thënë se tani është i rëndësishëm zbatimi i Marrëveshjes së 19 prillit, se një gjë e tillë mund të jetë pjesa më e vështirë në bisedimet Prishtinë-

Beograd, por “ajo do të çojë kah mundësitë më të mira ekonomike dhe një jetë më e mirë për qytetarët”.

Duke theksuar rëndësinë e zgjedhjeve lokale në Kosovë, të cilat do të mbahen më 3 nëntor, Reeker ka thënë se është e rëndësishme që të inkurajohen banorët që të marrin pjesë në këto zgjedhje.

Zyrtari amerikan i ka bërë këto komente në një konferencë për gazetarë në Nju Jork.

Më 20 Gusht, 69-vjetori i formimit të Brigadës 16-të Sulmuese

Brigada që çliroi qytetin e Fierit

Brigada e 16 Sulmuese u formua më 20 Gusht 1944 nga luftëtarët e Grupit të parë dhe Grupit të tretë të Beratit, si dhe nga mjaftë partizanë të tjerë të rinj nga krahina e Skraparit dhe e Kurveleshit. Inagurimi i saj u bë në katundin Therepel të qarkut të Beratit dhe si zonë veprimi kishte qarkun e Beratit dhe krahinën e Myzeqesë. Pasi kreu një punë përgatitore për organizimin e saj, brigada u hodh në mësymje kundër forcave armike.

Në ditët e fundit të muajit Gusht 1944 forcat e saj organizuan një varg pritash kundër autokollonave armike në rrugën Berat-Lushnje. Me 2 shtator ato sulmuan nazistët gjermanë në Mbrostar dhe, pasi i shpartalluan, dogjën pesë depo me municion e material tjetër ushtarak. Pas këtyre aksioneve forcat e Brigadës 16-të Sulmuese filluan pastrimin e Myzeqesë nga gjermanët dhe tradhëtarët. Gjatë luftimeve këtu u zunë qindra pushkë, dhjetra mitralozë e municion i shumtë dhe radhët e brigadës u shtuan me qindra bij e bija të Myzeqesë.

Më 8 shtator 1944, një batalion i brigadës goditi një autokolonë prej 15 maqinash me nazistë



gjermanë në rrugën Fier-Lushnjë. Në këtë pritë u vranë shumë hitlerianë dhe pjesa më e madhe e maqinave u dogj. Të nesërmen hitlerianët kundërsulmuan me forca të shumta, por në saj të heroizmit të partizanëve, u detyruan të tërhiqen në panik, duke lënë në fushën e luftës shumë të vrarë, të plagosur, robër dhe material luftarak.

Me 13 shtator 1944 brigada sulmoi në befasi nazistët gjermanë brenda në aytetin e Fierit dhe preu rrugën Lushnjë-Fier-Vlorë. Pasi u shkaktoi dëme të mëdha armiqve, ajo u tërhoq në fshatrat për rreth Fierit.

Prej kësaj kohe dhe deri në dyjavëshin e parë të tetorit '44, forcat e Brigadës 16-të Sulmuese, të vendosura në pozicione luftimi gjatë rrugës Fier-Vlorë, Fier-Lushnje dhe Berat-Lushnje goditën pa rreshtur kolonat gjermane në tërheqje.

Vetëm me 6 tetor 1944, në kodrat e Fier-Sheganit forcat e Brigadës zhvilluan një sulm kundër një autokollone prej 96 maqinash të shoqëruara me pesë tanke. Në këtë luftim gjetën vdekjen 35 nazistë dhe shumë të tjerë u plagosën. Mbi 41 automobila u dogjën ose u shkatërruan. Në këtë luftë ranë dëshmorë 12 partizanë, ndërmjet të cilëve Rrapo Luçi, Niko Bozo, Liri Gero dhe u plagosën tetë partizanë.

Me 15 Tetor 1944 forcat e Brigadës 16-të Sulmuese çliruan Fierin, ndërsa më 20 Tetor një pjesë e tyre ndihmoi Brigadën e 8-të për çlirimin e Lushnjës. Armiku la mbi 100 të vrarë, shumë të plagosur dhe materiale luftarake. Ne humbëm 56 partizanë trima.

56 dëshmorët e Brigadës 16-të Sulmuese

Avdyl Shehu

Abedin Mehmet Zylyftari

Abedin Mollasi

Arqilini Stamo

Andon Basha

Asllan Hamfi

Andrea Profi

Dhiogjen Vito

Elmas Sulo

Feride Hakimi

Gani Isuf Zhuga

Hazbi Mustafaj

Haxhi Hamiti

Nazif Kordani

Ibrahim Tafili

Ibrahim Dauti

Izet Rrapo Hekali

Islam Klosi

Isuf Seferi

Isuf Zyka

Izet Pronoça

Kozma Ndreka

Kozma Vojo

Liri Gëro

Maze Ose

Maliq Xharaku

Maliq Sanxhanaku

Miti Kosta Mitrushit

Murat Maliqi

Mustafa Radonicka

Mustafa Haxhia

Myqerem Xhumari

Nako Bozo

Pilo Milja

Petro Qose

Rrapo Luçi

Reshit Daulle

Rahman Backa

Sadush Myftari

Sadik Syzezi

Sali Hyseni

Selim Çela

Serjan Riza

Sulo Goxho

Shaban Çela

Shaban Turku

Tosum Sulejmani

Imer Fieri

Imer Tafai

Imer Hyseni

Ilija Stavri Zoto

Vangjel Sota

Italiani Volpata

Vedat Dokollari

Zabit Kërkuti

Italiani Xhuzepvep

Brigada e vëllazërimit shqiptar

Brigada e 19-të Sulmuese u krijua me 29 gusht 1944, në vendin historik të luftimeve shqiptare të këtyre anëve, në Theolloqo. Kjo krahinë, në periudhën e rezistencës kundër fashizmit, në vitet 1939-1944 ka mbajtur peshën kryesore të organizimit dhe grumbullimit të luftëtarëve të lirisë kundër pushtuesve dhe tradhëtarëve të vendit. Këtu janë përjetuar ngjarje të rëndësishme luftarake, kanë rënë dëshmorë dhe heronj, të cilët janë përjetësuar në këngë e lapidare.

Ceremonia e krijimit të Brigadës ka qenë e thjeshtë. Ajo ka përmbledhur Grupin e Katërt të Zonës së Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë, të përbërë nga pesë batalione me partizanë nga krahina të ndryshme të Shqipërisë së Jugut. Në të bënte pjesë edhe një batalion partizan italian, prandaj dhe u quajt "Brigada e Vëllazërimit". Bashkëjetesa dhe mirëkuptimi ishin

karakteristikë e partizanëve me kombësi, shtetësi e gjuhë të ndryshme.

Pjesa më e madhe e partizanëve sapo ishin kthyer nga luftime të ashpra që zhvilloheshin prej dy ditësh për çlirimin e qytetit të Konispolit. Ata dhanë aq shumë për luftën dhe lirinë e tyre të shumëpritur. Në këto luftime, armikut iu shkaktuan humbje të mëdha në njerëz dhe materiale ushtarake. Nga ana jonë, ranë në fushën e nderit për të mos vdekur kurrë: Skënder Komedenti, Panajot Larto, Llambi Bozhiqi, Vangjel Nuni dhe komisar i kompanisë së parë Kosta Çavo dhe u plagosën shumë të tjerë.

Në forcat e Brigadës 19-të Sulmuese bënë pjesë partizanë nga Çeta e Çamërisë dhe ajo e Pogonit të krijuara përkatësisht në vitet 1942 dhe 1943. Gjithashtu bënte pjesë edhe çeta e Dropullit të Sipërm. Mbi bazën e këtyre çetave ishin krijuar batalionet "Thanas Ziko", "Pandeli Boçari",

"Lefter Talo" dhe batalioni "Mataoti" me partizanë italianë.

Brigada e 19-të u organizua mirë në pesë batalione dhe zhvilloi një sërë operacionesh luftarake për çlirimin e të gjitha qyteteve dhe fshatrave të Jugut të Shqipërisë, duke e pastruar vendin nga pushtuesit e tradhëtarët deri në kufirin me Greqinë.

Luftime të përgjakshme janë zhvilluar sidomos në zonën e Pogonit, Konispol dhe Delvinë nga ku u krijua mundësia për përparimin e mëtejshëm të batalioneve të brigadës në drejtim të Gjirokastrës dhe të zonave të tjera, duke zhvilluar luftime në vendet kyçe për bllokimin e qafave dhe grykave, të rrugëve dhe urave-vende këto strategjike që i bënë të pamundura operacionet armike.

Nga kjo brigadë ranë heroikisht në fushën e nderit Heronjtë e Popullit Lefter Talo e Mustafa Matohiti.

Çdo vit populli i këtyre anëve mblidhet në përvjetorin e krijimit të Brigadës 19-të Sulmuese për të përkujtuar vend luftimeve të heroizmit masiv, jetën dhe veprën heroike të heronjëve dhe dëshmorëve.

70-vjetori i kryengritjes së Matit, festë në Burrel



Parku "Nëna Mbretëreshë Geraldinë" në qytetin e Burrelit ishte qendra e festimeve me rastin e 70-vjetorit të kryengritjes popullore të Matit. Me këtë rast në parkun e sipërpërmendur duke filluar nga ora 10:00 e datës 31 korrik u prezantuan ekspozita pikturë dhe fotografike, një panair i librit të autorëve matjanë, një panair tjetër i produkteve të zejeve tradicionale popullore, si dhe një panair i prodhimeve blegtorale të fermerëve të zonës.

Për këtë festë nuk janë harruar edhe fëmijët, pasi për ata u shfaq një pjesë

teatrore kukullash, lojëra zbavitëse, sporte dhe aktivitete të tjera në natyrë. Në mbrëmje, në orën 10:00, në sheshin "Ahmet Zogu" të qytetit u zhvillua një koncert festiv me grupe artistike nga Mati, Gjilani, Hasi, Rrësheni ku nuk munguan dhe artistë të ftuar nga Tirana. Ky aktivitet, i cili u zhvillua në kuadër të 70 vjetorit të kryengritjes popullore të Matit ishte dhe një nga ngjarjet më të rëndësishme gjatë këtij sezoni, që ka angazhuar jo pak artistë, shkrimtarë, etj.

Më 31 korrik të vitit 2013 populli i rrethit të Matit u mblodh në qendër të këtij rrethi, Burrel për të festuar jubileun e 70 të çlirimit të saj, për të nderuar heronjtë dhe dëshmorët e trevës së Mati. Menjëherë pas krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë më 10 korrik të vitit 1943, ka qenë një tjetër datë historike që erdhi pas 21 ditësh, atë të 31 korrikut të po këtij viti, Kryengritjen Popullore të Matit që shpartalloi garnizonin fashist italian dhe licenoi ditën e çlirimit të rrethit Mat. Ndryshe nga herët e tjera kur ky aktivitet edhe se rrallë here organizohet, drejtohej, e zhvillohej në ambientet e muzeut të këtij rrethi, kësaj radhe është organizuar e drejtuar nga një grua e rrallë që sot është në detyrën e Kryetares së Bashkisë Burrel znj. Adelina Farrici, e cila për organizimin, drejtimin e këtij aktiviteti të madh historik dhe që e realizoi me sukses, do të mbetet e gjallë në arkivin historik të këtij rrethi jo vetëm për këtë, por dhe për aktivitetet e ideuara prej saj që sillnin një planizim të dukshëm në vijimësi që rikthente dallueshëm traditën e dikurshme të festimeve që nderonin të rënë dhe jo si deri më tani që pushtetarët e djathtë nderonin ata që kanë qenë bashkëpunëtorë me tradhtarët e vendit, dhe në vend të nderimit të këtyre dëshmorëve që dhanë jetën për çlirimin e Matit u zëvendësuan me ata që u vunë përballë dhe luftuan kundër këtyre dëshmorëve, nga ata pushtetar

që sot mungojnë të marrin pjesë në nderime të tilla. Pjesëmarrja masive në këtë vit jubilar të 70 -vjetorit të çlirimit të rrethit, tregoj atë që mjaft matjanë nuk i janë bindur urdhrave të verbra partiake për të mos qenë pjesë e këtij aktiviteti historik e tradicional në nderim të atyre që bënë luftën, e që sot marrin pjesë si veteranë të kësaj lufte, dhe të atyre që dhanë jetën në këmbim të lirisë dhe që sot janë dëshmorë të atdheut si : Abdi Kryekurti, Ali Likcani, Ali Pali, Bardhok Ndoj, Fadil Cenameti, Gani Çira, Hajrie Burreli, Haxhi Lata, Hysen Hysa, Ibrahim Likcani: Ismail Heta, Ismail Tusha, Osman Gjasta, Qazim Bala, Shahin Kola, Xhelal Kurti.

Si u zhvillua aktiviteti

Në këtë aktivitet morën pjesë veteranët e luftës e të punës, familjarë e të afërm të dëshmorëve, qytetarë të Burrelit dhe banorë të komunave të rrethit. Pati dhe të ftuar nga rrethet fqinjë të Mirditës, Kukësit dhe Kurbinit. Gjithashtu, të pranishëm ishin dhe deputetët socialist: ish- deputeti Qamil Minxhozi, deputeti i Dibrës, Shkëlqim Cani tani Ministër i Financave , Kryetari i Partisë Socialiste të Matit Hasan Ceni, si dhe shumë të ftuar të tjerë që kanë dhënë kontribute në këtë rreth. Pritej si zakonisht mungesa e Prefektit të Dibrës Genc Sharsi, si dhe Kryetarit të Këshillit të Qarkut Naim Gazidede. Nisja e këtij aktiviteti u bë në orën 09:30, ku grupet e

veteranëve të luftës të shoqëruar dhe nga qytetarë të thjeshtë, u nisën për të bërë homazhe tek lapidari kushtuar kësaj date, tek muzeu historik dhe tërë gjatësia e rrugës nga Bashkia tek Muzeu u bë nën ritmin e muzikës së bandës frymore të ushtrisë.

Organizatorja e këtij aktiviteti znj. Adelina Farrici pasi uroj pjesëmarrësit për prezencën e tyre në këtë aktivitet historik e tradicional, ajo u tha të pranishmëve: Kam nderin dhe privilegjin ta hap këtë event të sotëm të 70 -vjetorit të kryengritjes së popullit matjanë dhe ndihemi krenarë që jemi Matjanë dhe bijë të kësaj treve liridashëse dhe vazhdues të traditës së të parëve tanë. Është detyrë e jona ta mbajmë të gjallë e të freskët dhe t'i përcjellim ndër breza, e mbyll fjalën e saj znj. Farrici, e cila ftoi historianin Sefer Duka që i bëri një ekspozitë zhvillimeve të kësaj kryengritje, e cila mbeti në histori ajo datë e fillimit të kësaj kryengritje të 31 korrikut të vitit 1943 që certifikoi datën e çlirimit të Matit. Ndaj sot, ne festojmë 70 -vjetorin e çlirimit si një datë historike tha në fund historian matjan, z. Sefer Duka.

Pastaj nën shoqërimin me muzikë funerabël nga banda frymore e ushtrisë, në lapidarin kushtuar kësaj date u vendosën disa kurora me lule. Në emër të bashkisë kurorën e vendosi Adelina Farrici dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak Qazim Gjoni. Si asnjëherë tjetër një kurorë është vendosur nga N/prefektura Burrel edhe

se drejtuesi i saj i takon së djathtës, Por mesa duket, ky zyrtar i ka kaluar realitetit, ndërsa një kurorë u vendos në emër të njësisë ushtarake të rrethit Mat.

Pastaj Historiani Sefer Duka i ftoi pjesëmarrësit që të jenë pjesë e shpjegimit e të njohjes së veprimeve luftarake të kësaj lufte, nëpërmjet stendave të afishuara në muzeun historik të Matit të kryengritjes popullore, që u shpjeguan nga historian Duka.

Pjesëmarrësit ju drejtuan parkut "Nëna Mbretëreshë Geraldinë" ku aty ishte ekspozuar panairi shumë kulturorë që paraqiste prodhimet nga krahina e Matit. Si dhe ekspozitë me piktura dhe fotografi, panair libri nga autorët Matjanë, promovim i vlerave artistike popullore, gdhendje në dru, instrumente popullore, kostume popullore, panair i produkteve blegtorale e bujqësore të fermerëve të zonës, të cilët i mrekulloi të gjithë vizitorët e shumë të asaj dite, shumë nga pjesëmarrësit ndoqën dhe ndeshje futbollit për fëmijë dhe të rritur.

Ajo që ra në sy në program ishte pritja zyrtare për qytetarët, miq, artistë dhe të ftuar nga Kryetarja Adelina Farrici. Në fund të këtij aktiviteti që shënon fundin e programit në sheshin "Ahmet Zogu" për qytetarët e Burrelit, grupet artistike të Matit, Gjilanit, Hasi, Rrëshenit e Tiranës, dhe këngëtarët më të mirë Matjanë dhanë një koncert festiv.

(foto: 70 vjet nga kryengritja e Matit)

Dy shqiptarët e ajrit të rënë në krye të detyrës shpallen "Qytetarë Nderi" të komunave Tomin dhe Maqellarë

Dibra nderon dy ish pilotët Sefedin Tomçini dhe Sabri Toçi



Një ceremoni mbresëlënëse u organizua në sallën e Shtëpisë së Kulturës Peshkopi me rastin e dhënies së titullit "Qytetar Nderi" dy ish pilotëve të Forcave tona të Armatosura, dëshmorëve të Atdheut, Sefedin Hasan Tomçini dhe Sabri Shefki Toçi. Salla ishte mbushur plot e përplot nga të afërmit e dy aviatorëve të rënë në krye të detyrës dhe shumë bashkëfshatarë e bashkëqytetarë të tyre.

Kishin ardhur për të marrë pjesë në këtë ceremoni edhe përfaqësues të Armës së Aviacionit Kombëtar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shoqatës së Aviatorëve të Rënë në krye të detyrës. Kishte ardhur për të nderuar ish kolegët e tij edhe piloti i parë i rrethit të Peshkopisë, z. Allaman Isaku. Ishin të pranishëm gjithashtu edhe kryetari i Bashkisë së Peshkopisë z. Ilir Krosi, deputeti Sherefedin Shehu etj.

Ceremonia u hap me ekzekutimin e Hymnit Kombëtar. Pastaj e mori fjalën kryetari i Komunës Tomin, Z. Sadik Cena, i cili lexoi motivacionin, me të cilin kjo Komunë i jepete titullin "Qytetarë Nderi" ish pilotit Sefedin Tomçini dhe i dorëzoi diplomën përkatëse të shoqes, zonjës Suzana Tomçini. Pas tij në tribune doli kryetari i Komunës së Maqellarës, z. Bardhyl Agolli, i cili lexoi motivacionin për ish pilotin Sabri Toçi dhe i dorëzoi diplomën përkatëse bashkëshortes së tij.

Duke falënderuar për këtë nder që i bëhet bashkëshortit të saj pas rënies në krye të detyrës, zj. Suzana Tomçini mbajti një fjalë shumë të ndjerë dhe prekëse. Midis të tjerash, ajo tha: "Ju falënderoj me gjithë zemër për këtë vlerësim që i bëhet Sefedit, pas titullit të lartë "Dëshmor i Atdheut". Megjithatë kanë kaluar shumë vite nga dita e rënies, vendi i lindjes, vendi ku u rrit, u shkollua dhe ku pati shumë shokë e miq, jo vetëm që nuk e ka harruar, por e nderon me këtë titull të lartë. Ju falënderoj nga zemra të gjithëve. Në këtë çast kaq prekës dua të përulë para kujtimit të babë Hasanit, burrë i shquar e trim, dhe nënës Shime, gruas gojëmbël e të palodhur, që lindi e rriti 9 fëmijë- shtatë djem e dy vajza, ndër të cilët edhe Sefedinin.

Sefa ishte një djalë me virtyte të rralla. Ishte i dashur, i respektueshëm, punëtor i palodhur, i thjeshtë, i mençur, shakaxhi, poet dhe krijues. Ishte baba shembullor. E donte jetën, por Atdheun e donte edhe më shumë. Tek Atdheu ishte jeta e tij, të cilin nuk hezitoi t'ia falte atë në mënyrën më heroike...

Në çdo çast të jetës sime jam ndjerë krenarë që kamë qenë nuse në familjen e Hasan Tomçini, me tradita patriotike e vlera të larta, me të cilat unë krenohem kudo që ndodhem. Unë vetë jam me origjinë nga Libohova, por gjysma ime tashmë është kthyer dibrane. Unë me Sefedinin jetova 8 vjet, pra shumë pak, pasi rënia e tij në krye të detyrës, na ndau. Jam munduar të rris dy vajzat e mia Eldën dhe Arlindën, vetëm dhjetëmuajshe, duke patur si busull

Sefedinin në çdo çap që bëja e hidhnja. Doja që ato të rriteshin e ti ngjanin babait të tyre, të mençura e punëtore. Dhe sot mund të them se ia arrita qëllimit për betimin në heshtje që kisha bërë. Por, këtu nuk mund të lejë pa përmendur ndihmën e pakursyer që kanë treguar për neve vëllezërit e Sefes: Sula, Nexha, Seiti, Përparimi, Fatosi, Safeti dhe Drita e Bidja, shokët e tij si Safet Zhulali dhe të gjithë dibranët zemërmirë.

Kur vij në Peshkopi, tek çdo dibran që takoj, shoh sikur takoj një pjesë të Sefedit. Këtu në Peshkopi, unë ndjehem si në shtëpinë time.

Për Sefedinin kam kujtime të bukura, të

paharruara e mund të flas me orë të tëra, por sot dua të kujtoj diçka: E pyesja shpesh: "Dine! Ç'farë do të bësh kur të dalësh në pension?" Ai më përgjigjej me plotë gojë: "Do të shkojë në Pollozhan, ku kam lindur, se më merr shumë malli jo vetëm për shokët, miqtë por edhe për gurët e rrugës se fshatit dhe bulevardin e bukur të Peshkopisë..."

Edhe një herë ju falënderoj të gjithëve që po kujtoni këta dy bijë të shquar të Dibrës heroike: Sefedinin dhe Sabriun. Dy djem të rinj, që punuan e vigjëluan në radhët e Ushtrisë me nder dhe që ranë në krye të detyrës për Atdhe.

Kurse bashkëshortja e dëshmorit Sabri Toçi, Teuta, pasi falënderoi për titullin që Komuna e Maqellarës i dha bashkëshortit të saj, duke iu drejtuar familjarëve të burrit të saj, u shpreh: "Unë zgjodha të jem pjesë e familjes tuaj fisnike dhe jam e lumtur për këtë. Edhe pse fati nuk deshë që Sabriu të ishte përkrahë meje, unë asnjëherë nuk jam ndjerë e vetme, sepse kam gjetur kurdoherë ngrohtësinë, mirëkuptimin dhe ndihmën tuaj.

Edhe pse i rritur pa baba, djali im asnjëherë nuk është ndjerë si jetim, pasi ju vëllezërit, motrat dhe ju kushërinjtë e Sabriut i dhuruat ngrohtësi, afërimitet dhe shumë dashuri. Një falënderim të veçantë edhe për ju dhe gjithë familjet tuaja."

Ajo foli edhe për Sefedinin, duke thënë se ai mungon sot në këtë atmosferë kaq të bukur e prekëse, por unë e shoh atë në fytyrat tuaja, e shoh atë në sytë tuaj, në sytë e vajzave të tij Eldës dhe Arlindës si dhe të bashkëshortes së tij Zanës. Unë, për aq pakë kohë që munda ta njohë, e konsiderova atë një vëlla tjetër të Sabriut."

Pastaj e morën fjalën përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Organizatës së Aviatorëve të Rënë në krye të detyrës.

Një fjalë njaftë vlerësuese mbajti edhe kryetari i Bashkisë së Peshkopisë Z. Ilir Krosi. Ai, duke evokuar jetën dhe trimërinë e dy Dëshmorëve të Atdheut, Sefedin Tomçini e Sabri Toçi, theksoi se "Dibrës në historinë e saj kurrë nuk i kanë munguar trimat dhe patriotët, që për tokë e Atdhe nuk kanë kursyer as pasuri, as jetën dhe asgjë tjetër".

Në fund për të pranishmit u dha një koncert nga grupi i Shtëpisë së Kulturës. Për të pranishmit këndoi edhe këngëtari i njohur nga Kosova Ilir Shaqiri, i cili këndoi me shumë shpirt e pasion një këngë kushtuar shqiptarëve shqiptarë të ajrit, të kompozuar nga kompozitori i njohur dibran Përparim Tomçini, duke emocionuar e përlotur të pranishmit e sidomos të afërmit e dëshmorëve.

Në fund nga të afërmit e dy dëshmorëve u dha një koktej, që u karakterizua nga po ajo fryme që karakterizoi gjithë ceremoninë.

Përkujtohet 30-vjetori i ndarjes nga jeta të intelektualës së shquar Musine Kokalari

Dritë e pashuar e kulturës shqiptare

Musineja, një intelektuale e kompletuar e tipit perëndimor, mendonte ndryshe nga Enver Hoxha, i cili e ndjente rrezikun e intelektualëve, sidomos atyre opozitarë, ndaj i vrau, burgosi i internoi, i persekutoi, ibloi ata në luftën e përbindshme të klasave. Kështu bëri edhe me Musinenë, pasi ajo nuk u bë kurrë komuniste dhe vegël e Enver Hoxhës. Asaj iu bë thirrje që të futej në Partinë Komuniste, por ajo nuk pranoi të ishte anëtare

(vijon nga fq 1)

Çastet e fundit të jetës

Në dorëshkrimin "Mbi jetën time", Musineja shkruan: "Komunistët më varrosën për së gjalli, se nuk iu kërkova falje në gjyq për aktivitetin tim. Dhe pse do të kërkova falje?... Unë s'jam fajtorë...". Në një seancë gjyq, ndërsa dikush thirri se ajo duhet të dënohej me vdekje në litar, dhe kryetari Frederik Nosi, e pyeti se a e dëgjonte atë që kërkonte popullit, Musineja me qetësi iu përgjigj: "Nesër këtë do të thonë edhe për ju". Musineja nuk pranoi avokat, ajo bëri një apologji të shkëlqyer që e jep qartë edhe në qëndrimin e saj prej politikaneje demokrate, konsekuente dhe e papërljer. Gjyqi komunist e dënoi me 20 vjet heqje lirie, me hubjen e të gjitha të drejtave civile dhe kufiskim të pasurisë. Pasi kreu 16 vjet nga dënimi i saj, Musinenë e internuan në Rrëshen, ku për 22 vjet punoi në bujqësi dhe ndërtim, si punëtore llaçi, e përgjuar ditë e natë nga Sigurimi i Shtetit. Pas punës, ajo shëtiste vetëm, por dhe shkante në vendin e saj të preferuar, bibliotekën e qytetit, ku gjente miqtë e saj të vërtetë, librat. E dërmuar nga vuajtjet dhe e raskapitur nga punët e rënda, Musineja u sëmur nga kanceri.

"Ç'fat tragjik, shkruan ajo. Më doli edhe sëmundja kundër. Të paktën të kisha pak qetësi në vitet e fundit të jetës sime". E shtruar në spitalin onkologjik, ajo shkruan: "Këtu kuptova një gjë. Për mua jo vetëm që nuk interesohen, por kanë qejf të më zvarritin. Dhe vetë kontrolllet e këtyre muajve s'kanë gjë tjetër veçse fjalë të kota. Sipas rregullave, unë duhet të isha operuar këtu e gjashtë muaj më parë. Ç'është ngjasë?". Duke iu referuar epilogut, diçka nga përvoja e saj: "Njoha kulturën demokratike, njoha tragjedinë e përbysjeve të mëdha revolucionare. Njoha një gjyq special. Njoha 16 vjet burg dhe 22 vjet internim me përplasje andej-kënde. Njoha punën e punëtorit me normë individe, njoha punën e krahut me normë kolektive në bujqësi e ndërtim. Njoha vetminë e vetëkërkuar,

e një partie, që drejtohej nga serbët dhe e futi Shqipërinë në diktaturën më të egër e më të përgjakshme të historisë së saj.

Musine Kokalari ishte e dashur, e butë, e ditur, e zgjuar dinjitoze dhe me karakter të fortë, në kundërshtim me antinjerëzoren e njeriut të programuar, të njeriut "të ri" që ushqehet me luftë dhe urrejtje, ateist, pa personalitet që zhbiron të tjerët, konformist e servil, formatuar i varur dhe i nënshtruar.

shoqërinë e rastit në burg dhe gjithë ndryshimet që pasojnë nga ky tërmet i pandërprerë për të konsoliduar diktaturën e proletariatit. Nganjëherë them me vete se nuk fitova gjë që mbeta gjallë. Kam 38 vjet që nuk e di ç'domethënë familje. Ndoshta do të ishte mirë të kisha mbyllur sytë njëherë e përgjithmonë. Kështu merrnin fund edhe vuajtjet, me gjithë gjendjen tragjike. Kjo do të ishte një gjë shumë e mirë. Nëse vdes, në valixhen e vogël kam disa sende me vlerë etnografike për Muzeun e Gjirokastrës. Ato pak kurtime dhe gjithçka tjetër le të hyjë në fondin e shtypit që duhet të krijohet për punëtorin e krahut, i cili është i domosdoshëm, që të demokratizohet puna e krahut dhe të kultivohet punëtori i thjeshtë".

"Për shëndetin tim nuk i drejtohem kujt, aq më pak atij që kishte në dorë të më lehtësonte dënimin". Kështu shkruante Musineja vetëm pak kohë para se të vdiste, duke lënë të kuptohej se "ai" nuk ishte veçse Enver Hoxha, i cili u kujdes deri në fund për dënimin e saj. E konsideruar si kundërshtarë e regjimit komunist, ajo u dënua me 20 vjet burg dhe më pas u internua për 22 të tjerë në Rrëshen, ku vdiq në vitin 1983, nga kanceri. Bashkëkohësit tregojnë se nuk iu dha mundësia as të kurohej në spitalin onkologjik. Vdiq e vetme dhe u varros nga varrmihësit. Kur e zhvarrosën vite më vonë, u pa se duart e saj ishin të lidhura me tela me gjemba.

Falë ditëve që erdhën u mundësua të thuhet e vërteta për personalitete të tillë si Musine Kokalari. Diktatura e burgosi, e internoi, e vdiq, por nuk e varrosi dot. Ajo i mbeti e gjallë popullit dhe atdheut, si një dritë e pashuar e kulturës shqiptare, si flakadan i përjetshëm i demokracisë. Nga piedestali ku e vendosi koha, ajo na mëson: "Besa, shpresa, dashuria, ato pra na lartësojnë. Përçarja dhe marrëzia na poshtërojnë dhe na mjerojnë".

